

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit B. R., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.3598/2015 të datës 14.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Beqë Shala, dhe të akuzuarit, me datë 05.01.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. R., nga i ati H. dhe nëna Xh. e lindur M., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin P., Komuna e M., tani jeton në Prizren, rruga pa numër, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se prej datës së pavërtetuar e gjerë me datën k07.07.2015 në Prizren, në shtëpinë ku banon, në rrugën e..., pa numër, përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet përmes rrjetit përques të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte pa njehsor elektrik, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material,

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52 al.5, 73, 74, 75, 76 dhe 320 të KP-ës, të akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 10 (dhjetë) ditë burg.

E dëmtuara: KEDS Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.3598/15 të datës 14.12.2015, kundër të akzuarit B. R., nga Prizrenit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Beqë Shala në fjalën e tij përfundimtare deklaron: mbes në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.3598/2015 të datës 14.12.2015, të parashtruar ndaj të pandehurit B. R., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, paraprakisht duke i marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I akuzuari B. R., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj në tërësi veprën penale e cila më vihet në barë me aktakuzën të ngritur ndaj meje, unë jam në punë të përkohshme në Zvicër, andaj me rastin e ndërtimit të shtëpisë të re, instalimin e energjisë elektrike dhe pajisjeve tjera përcjellëse të shtëpisë i kam lënë për kujdesie vëllaut tim, kur kam ardhur nga Zvicra, e kam parë që rryma ishte e instaluar, unë kam menduar që energjia elektrike ka qenë e instaluar në mënyrë të drejtë, por pasi që kam ardhur në pushime, kam kuptuar me rastin e kontrollimit nga ana e zyrtarëve policor që energjia elektrike është e instaluar drejt për drejt pra ka qenë lidhje direkte. Andaj nga të cekurat edhe e pranoj fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barë, por i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, të ketë parasysh rrethanat e cekura më lart, dhe atë pranimin e fajësisë nga ana ime, që jam person familjar, baba i tre fëmijëve, kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se prej datës së pavërtetuar e gjerë me datën 07.07.2015 në Prizren, në shtëpinë ku banon, në rrugën e ..., pa numër, i akuzuari përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte pa njehsor elektrik, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material,

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimit i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës, paraparakisht duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i tre fëmijëve, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, duke menduar se dënimin i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2100/2015 me datë 05.01.2017

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.